



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr._____, datë_____/_____/2025

**“PËR NGRITJEN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR BASHKËPUNIMIN
TERRITORIAL EVROPIAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 110 të Ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave:

V E N D O S I:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian, si organ këshillimor pranë negociatorit përgjegjës për Kapitullin 22 “Politikat Rajonale të BE-së”, për bashkërendimin e veprimtarive shtetërore në programimin e programeve ndërkufitare INTERREG dhe IPA pas vitit 2027. Roli i Komitetit është të sigurojë mbështetje për pjesëmarrjen së autoriteteve shqiptare në grupet e punës dhe komitetet përkatëse të programimit për programet ndërkufitare INTERREG dhe IPA, si dhe të mundësojë përcjelljen e mendimeve dhe komenteve të tyre pranë këtyre strukturave.
2. Komiteti kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtarë:
 - a. Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV);
 - b. Drejtorin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit;
 - c. Tre përfaqësues, kryetar bashkie, të zgjedhur nga shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH), duke garantuar pluralitet politik dhe përfaqësim gjeografik dhe territorial.
 - ç. Një përfaqësues i zgjedhur nga shoqata e Qarqeve;
3. Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:
 - a. Promovimin dhe koordinimin e pjesëmarrjes së njësive të qeverisjes vendore në të gjitha programet e Bashkëpunimit Territorial Evropian;
 - b. Identifikimin e çdo pengese strukturore që ndikon në pjesëmarrjen e njësive të qeverisjes vendore në programet e Bashkëpunimit Territorial, si dhe mekanizmat për mënjanimin e tyre;

- c. Siguron angazhimin dhe konsultimin e aktorëve të ndryshëm në nivele të ndryshëm qeverisje në lidhje me Strategjinë e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR);
 - ç. Garantimin e pjesëmarrjes së njësive të qeverisjes vendore shqiptare në procesin e programimit në nivel kombëtar për programet e bashkëpunimit territorial INTERREG dhe IPA;
 - d. Shpërndarjen e rezultateve të projekteve të Bashkëpunimit Territorial Evropian dhe praktikave më të mira;
4. Komiteti mblidhet jo më pak se një herë në gjashtë muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryetarit.
5. Mbledhjet e Komitetit mund të zhvillohen edhe në formë elektronike (online). Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të organeve të qeverisjes qendrore e vendore të tjera apo të institucioneve apo aktorëve të tjerë, pjesëmarrja e të cilëve vlerësohet e nevojshme për përmbushjen e misionit.
6. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati Teknik i ngritur pranë SASPAC. Sekretariati Teknik kryen këto detyra:
- a. Grumbullon dhe përpunon komentet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve të Komitetit dhe njësive të tjera të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit;
 - b. Ndihmon dhe mbështet Komitetin me analizë ligjore dhe teknike në lidhje me programet, si dhe në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve.
 - c. Kujdeset për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të punës.
 - ç. Organizon panele diskutimi dhe konsultimi për tematika specifike me anëtarët e Komitetit dhe aktorë të niveleve të ndryshme të qeverisjes.
- d) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Komiteti.
7. Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe Shoqata e Qarqeve përzgjedhin anëtarët e Komitetit brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe njoftojnë menjëherë Sekretariatin Teknik.
8. Ngarkohen Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, SASPAC, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA